



DREJTËSIA

SHKURT 2012, NR. 2

BULETIN MUJOR INFORMATIV www.drejtesia.org



Delegacioni nga qyteti i Bursës viziton kryesinë e PD-së

Dega e Gjakovës mban tribunë

Arianit Sllamniku pritet të bëhet asambleist në KK të Gjilanit

Ligjet tona garantojnë manifestimin e lirë të bindjeve fetare

Të drejtat e njeriut dhe vandalizimi politik

Kontributi i prof. Feti Mehdiut në Asamblenë Komunale në Prishtinë

Delegacioni nga qyteti i Bursës, viziton kryesinë e PD-së

Të premten më 3 Shkurt një delegacion nga qyteti i Bursës e Republikës së Turqisë i kryesuar nga z. Ahmet Këllëç, Kryetar i Forumit Rinor të Partisë së Drejtësisë dhe Zhvillimit, vizitoj Ministrin e Shëndetësisë. Me këtë rast delegacionin nga Republika e Turqisë e priti kryetari i Partisë së Drejtësisë, prof. dr. Ferid Agani i shoqëruar nga nënkryetari për mërdhënie ndërkombëtare i Partisë së Drejtësisë z. Abdulah Klinaku, nënkryetarët z. Fahredin Majkovci dhe z. Qeram Telqiu si dhe anëtarët e Kryesisë z. Qemajl Hasani dhe z. Bernard Tahirbegolli. Kryetari i PD-së Agani i njoftojë për



punën dhe angazhimin e nënkryetarit për çështje rinore të Partisë së Drejtësisë, dhe punën brenda Ministrisë së Shëndetësisë. Në të njëjtën kohë mysafiri nga Turqia u informuar edhe për marrëdhëniet dhe aktivitetet me rini që janë zhvilluar mes Vizionit Rinor të PD'së dhe Forumit Rinor të Partisë së Drejtësisë dhe Zhvillimit në Turqi, nga ana e

nënkryetarit për çështje rinore z. Majkovci. Z. Ahmet Këllëç, përshëndeti pritjen që iu bë dhe shprehi gatishmërinë e tij për bashkëpunim edhe më të thellë me Partinë e Drejtësisë në Kosovë. Ai citoi " se ne jemi të përkushtuar të ju ndihmojmë dhe të ju shohim të gezuar, gëzimi juaj për ne do të thotë gëzimi ynë".



Dega e Gjakovës mban tribunë “Vlerat dhe univerzaliteti i të drejtave të njeriut”



Në këtë tribunë ligjërues ishin: Prof.dr. Ferid Agani, kryetar i Partisë së Drejtësisë, njëherit edhe Ministër i Shëndetësisë, Prof.dr. Zejnullah Gruda, Drejtor i Institutit për Hulumtime të krimeve të Luftës dhe Prof.dr. Fahrush ef. Rexhepi, zv. Kryetar i BIK-ut.

Partia e Drejtësisë, Dega në Gjakovë organizoj tribunë të hapur me temën “Vlerat dhe univerzaliteti i të drejtave të njeriut”, ku ligjërues ishin: Prof.dr. Ferid Agani, kryetar i Partisë së Drejtësisë, njëherit edhe Ministër i Shëndetësisë, Prof.dr. Zejnullah Gruda, Drejtor i Institutit për Hulumtime të krimeve të Luftës dhe Prof.dr. Fahrush ef. Rexhepi, zv. Kryetar i BIK-ut. Në këtë ligjërim Prof. Gruda, paraqiti në formë kronologjike zhvillimin e Të Drejtave të Njeriut dhe sfidat me të cilat u ballafaqua ky koncept gjatë historisë. Rëndësi të



posaçme profesor Gruda i kushtoj rregullimit ligjor të Lirive dhe të Drejtave ekonomike, kulturore dhe sociale në harmoni me konventat ndërkombëtare, si

tejet të nevojshme për zbatim në Kosovë. Ndërsa në vazhdim Prof. Fahrush Rexhepi, bëri një elaborim rreth të Drejtave të Njeriut në Islam si dhe rolin e

Islamit në harmonizimin e lirive dhe te drejtave të njeriut në aspektin ndër konfesional. Prof. Dr. Ferid Agani, si ligjëratare përmbyllëse elaboroj mjaft bukur dhe i kushtoj vëmendje të veçantë rolit të diskutimeve në diskursin Lindje – Perëndim rreth të Drejtave Universale të Njeriut. Ndër të tjera kryetari Agani potencoi vlerën e harmonizimit të legjislacionit me vlerat tradicionale në respektimin e

vlerave, lirive dhe të drejtave të njeriut. Dr. Agani i japi rëndësi të veçantë respektimit të manifestimit të bindjeve fetare. Me pjesëmarrjen në tribunë na nderoi edhe Prof. Dr. Jahja Koka, fizikant i lazerëve njëherit edhe ligjërues i kozmologjisë, i cili me dy tre fjalë rreth të drejtave potencoi dhe japi një mesazh shumë të mirë për ruajtjen e bilancit. Në fund, pati edhe pyetje rreth të cilave publiku u interesua për më tepër rreth të drejtave të

njeriut, aplikueshmërinë e tyre në Republikën e Kosovës, ku morën përgjigje nga paneli i profesorëve të nderuar.



Arianit Sllamniku pritet të bëhet asambleist në KK të Gjilanit

Arianit Sllamniku, kryetar aktual i Partisë së Drejtësisë (PD), Dega në Gjilan, së shpejti do të ulet në ulësen e Asamblesë Komunale të Gjilanit, pasi këtyre ditëve priten ndryshime në përbërjen e këtij organi më të lartë vendimmarrës në nivelin lokal. Sllamniku pritet ta zëvendësojë këshilltarin e vetëm që ka ky subjekt politik në Kuvendin e Gjilanit, i cili ka ofruar dorëheqje për arsye personale.



Është ky këshilltari i PD-së, Ibrahim Neziri, i cili ka ofruar dorëheqjen e tij, për shkak të një vizite studimore jashtë vendit.

Përndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit ka 41 anëtarë. Dy subjektet kryesore, PDK, që është në qeverisje dhe partia opozitare LDK (pas iu bashkuan edhe anëtarët e KK-së, që ishin më parë në LDD), kanë nga 14 vende, ndërsa ulëset tjera plotësohen nga AAK me 5, AKR, me 4, PSD 2 (duke përfshirë këtu ish këshilltarin e ORA), derisa PD dhe KDTP kanë nga 1 anëtar.

Ligjet tona garantojnë manifestimin e lirë të bindjeve fetare

Buletini Drejtësia zhvilloi këtë intervistë me z. Gëzim Kelmendi, Deputet në Kuvendin e Kosovës dhe diskutoi mbi zhvillimet më të reja në Shëndetësi, Parlament dhe në Partinë e Drejtësisë

Drejtësia: Si i vlerësoni zhvillimet e fundit në shëndetësinë Kosovare ?

Gëzim Kelmendi: Zhvillimet e fundit në shëndetësinë Kosovare shtrihen në dy rrafshë:

Në rrafshin e ndryshimeve pozitive të arritura si rezultat punës së palodhshme dhe profesionale të Ministrit të Shëndetësisë Prof.Dr.Ferid Agani.

Në rrafshin tjetër kemi arrestimet e zyrtarëve të lartë të kësaj Ministrie, ku ne besojmë se në ditët në vijim drejtësia do ta thotë fjalën përfundimtare.

Drejtësia: Sa do ta përmirësojnë gjendjen shëndetësore dhe sociale hyrja në fuqi e Ligjit të ri për shëndetësi dhe Sigurime shëndetësore ?

Gëzim Kelmendi: Padyshim se me miratimin e këtyre dy ligjeve: Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për sigurime Shëndetësore do të kemi reforma pozitive që do të rezultojnë me një zhvillim të mirëfilltë të shëndetësisë Kosovare në të gjitha sektorët e saj.

Me këto dy ligje që janë fryt i profesionalizmit të pashoq të Ministrit të Shëndetësisë

Prof.dr. Ferid Agani, shëndetësia kosovare në veçanti dhe qytetarët e Kosovës në përgjithësi do të përfitojnë në shumë sfera dhe do të shkojnë me hapa të sigurt drejt një sistemi shëndetësor të barabartë me sistemet shëndetësore europiane.

Drejtësia: Është me interes për opinionin të dihet se cilat do të jenë angazhimet e juaja pasuese për çështjen e shamisë (mbulesës), kur e dimë se as Kushtetuta dhe as Ligjet në fuqi nuk e ndalojnë atë?

Gëzim Kelmendi: Po, neni 38 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës tregon qartë se çdo qytetar i Kosovës ka të drejt të manifestoj publikisht bindjet e tij fetare, edhe ligji aktual i Republikës së Kosovës për arsimin parauniversitar garanton respektimin e lirë të bindjeve fetare, por siç e dimë të gjithë mbulesa (shamia) është e ndaluar në shkollat fillore dhe të mesme me një udhëzim administrativ të nxjerr në vitin 2010 nga ish Ministri i Arsimit Enver Hoxhaj.

Për më tepër, ky udhëzim apo kjo ndalesë e mbulesës nëpër shkolla është një çështje politike që kërkon një



“neni 38 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës tregon qartë se çdo qytetar i Kosovës ka të drejt të manifestoj publikisht bindjet e tij fetare...



Kosovës nuk është e fuqishme që mund të ndikojë shumë në ndryshimin e kësaj çështje politike.

Por, unë si deputet i PD-së së bashku me deputetin tjetër nga PD Jeton Svircen, jemi duke punuar dhe kemi hartuar një plan në lidhje me këtë çështje. Në këtë plan kemi përfshirë edhe deputet e tjerë nga subjektet tjera politike dhe shpresoj që brenda një kohë të shkurtër do të arrijmë që të nxjerrim ndonjë rezultat pozitiv. Për gjithë këtë aktivitet kemi mbështetjen e plotë të Kryetarit të Partisë së Drejtësisë, njëherit Ministrit të Shëndetësisë Prof.dr.Ferid Aganit.

Drejtësia: Në cilin Komision parlamentar jeni të

angazhuar, se cilat janë veprimet e juaja konkrete?

Gëzim Kelmendi: Unë si deputet i PD në Kuvendin e Kosovës, jam pjesë e Komisionit për shëndetësi punë dhe mirëqenie sociale.

Që nga fillimi i punës në këtë Komision kam dhënë kontributin tim maksimal që ligjet e amendamentuara të jenë sa më funksionale dhe praktike në jetën e përditshme.

Kam propozuar që ligji për Duhanin të ndryshohet dhe të ndalohej rreptësisht në gjitha hapësirat e mbyllura.

Kam kundërshtuar adoptimin e fëmijëve Kosovarë jashtë Kosovës, por në këtë pikë nuk kam pas mbështetjen e gjithë deputetëve tjerë të këtij

komisioni.

Në të gjitha projektligjet që kanë arritur deri më tash kam dhënë kontribuar në amendamentimin e tyre.

Drejtësia: Tani ju jeni nënkryetar i PD-së për çështje sociale dhe kulturore cilat janë planet tuaja?

Gëzim Kelmendi: Në Kuvendin e shtatë zgjedhor të Partisë së Drejtësisë jam zgjedhur Nënkryetar për çështje sociale dhe kulturore.

Që nga fillimi i mandatit tim kam nisur aktivitetet që kanë të bëjnë me këtë lëmi.

Kam filluar në Prizren, më pas në Gjakovë, tash do të vazhdojë edhe nëpër qendra tjera të Kosovës.



Jeton Svirca

Deputet i PD-së në Kuvendin e Kosovës

Kohën e fundit jemi dëshmitarë se çështja e bartjes së mbulesës nga vajzat e besimit islam është duke u keqkuptuar tej mase.

Si rezultat i kësaj janë përjashtuar nga procesi i mësimin një numër i konsideruar i vajzave, gjë që bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës, ligjin e miratuar për Arsimin Parauniversitar, si dhe konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me liritë e njeriut.

Është udhëzimi administrative i cili po merret si pretekst për përjashtimin e këtyre vajzave.

Bartja e shamisë nuk paraqet simbol fetar por normë fetare, andaj në këtë rast kemi cenim të lirisë fetare, shfaqjes së bindjes fetare dhe manifestimit të tyre.

Udhëzimi Administrativ është kategori nënligjore shumë me e ultë se sa Kushtetuta dhe Ligji, prandaj nuk mundet të kufizohet një e drejtë e njeriut me anë të akteve nënligjore e sidomos kur ajo e drejtë i njihet në konventa ndërkombëtare, Kushtetutë dhe ligj.

Andaj duhet shpjeguar organeve kompetente të arsimit në nivel qendre dhe lokal se udhëzimin administrativ, i cili fillimisht ka qenë nr 7/2009, dhe pastaj është modifikuar me datë: 11.05.2011. dhe aktualisht është numër: 6/2010, neni 4, pika 13, është në kundërshtim me:

Kushtetutën e Republikës së Kosovës:

Të drejtat e njeriut dhe vandalizmi politik

Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve

Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohe me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; ...

Neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë]

1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.

2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ndërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur

bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.

3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.

Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.

2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Është në kundërshtim me ligjin për Arsimin Parauniversitar:

Neni 1

Qëllimi

2.3 Zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

Neni 3

Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.

6. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me

dispozitat e këtij Ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinionëve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

Neni 4

Mbrojtja e grupeve të cenueshme

Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij Ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese.

Neni 50

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm (Ligji 2002/2) si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Në kundërshtim me Deklaratën e të Drejtave të Njeriut:

Hyrje

Mbasi njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; mbasi mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe mbasi krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga

frika e skamja është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu; Mbasi është e nevojshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes;

Neni 2.

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Neni 18.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Në kundërshtim me konventën MBI TË DREJTAT E FËMIJËS:

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi,

pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i

mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës,

veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 8

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij,...

Neni 14

1. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të

fesë.

2. Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

Pos këtyre argumenteve të lartcekura ka edhe argumente tjera të cilat për shkak të vëllimit nuk i prezantuar në këtë temë.

Veshja paraqet personalitetin e individit, karakterin e tij andaj çështja e shamsisë së kokës është krejtësisht një çështje e të drejtave të njeriut.

“Qëllimi i fundit i të gjitha të drejtave të njeriut është zhvillimi i plotë dhe i lirë i çdo personaliteti në kushte të barazisë.”

E në bazë të kësaj shoqëria civile duhet të jetë e hapur dhe t'i integrojë të gjithë personat, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare edhe personat me aftësi të kufizuara, e të mos flasim për femrat!

“Çdo njeri gëzon të drejtën e arsimimit”, dhe prapë edhe këtu nuk do të duhej të bëhet fjalë për

të drejtat e vajzave për shkollim, ngase kjo do të reflektonte një çështje tjetër dhe do të sillte deri tek diskutimi i shekujve të kaluar se “femra a është njeri apo jo”!

Prandaj arsimimi për një femër do të thotë të ketë mundësi të mësoj më shumë, të zhvilloj aftësitë dhe talentet, të bëj dhe mbaj miq, të ketë më shumë besim në vetvete, të shmang përfshirjen në krime, të ketë një zgjedhje më të madhe për punë kur të vijë koha për punë, të mos jetë barë e shoqërisë por promotor i ndryshimeve pozitive në shoqëri...etj”

Është shumë absurd - vandalizëm që njerëz të ndryshëm të marrin kompetenca dhe guxim dhe ju mohojnë arsimimin këtyre vajzave.

Përderisa vendet tjera preokupohen me problemin e mos shkollimit dhe braktisjes së shkollës tek ne i ndalojnë nxënëset nga shkolla!

Përderisa vendet tjera bëjnë politika për të i rikthyer në shkolla ata që e braktisin, tek ne pushtetarët nxjerrin udhëzime administrative dhe i largojnë nxënëset nga shkolla!

Ndërsa në anën tjetër shpenzohet buxheti i Kosovës për plane dhe strategji të ndryshme, në Kosovë po ashtu po bëhen përpjekje në disa çarqe që të krijohen kushtet për gjithpërfshirjen e fëmijëve në arsimin e obligueshëm.

Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë ka

definuar një objektivë strategjike për gjithpërfshirje, barazi dhe respektim të diversitetit në arsim. Kjo objektivë është konkretizuar me një masë e cila ka të bëjë me hartimin e politikave që sigurojnë përfshirje të plotë të fëmijëve në sistemin e arsimit. Në anën tjetër po bëhen përpjekje përmes projekteve të ndryshme që të trajtohet problemi i braktisjes së shkollimit, sidomos nga nxënësit që vijnë prej grupeve të rrezikuara (të varfrit, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga grupet minoritare, vajzat, fëmijët që punojnë, etj).

Në këtë kuadër vlen të përmenden intervenimet e financuara nga Banka Botërore, CRS, etj, në drejtim të parandalimit të braktisjes së shkollimit.

Ndërsa në aspektin e zhvillimit dhe shtet-ndërtimit themi se në vend që ta fusni në shkollë një të re ju po e largoni nga shkolla, në vend që të krijoni një punëtorë ju po krijoni parazitë, në vend që të krijoni intelektuale ju po krijoni amvise, në vend që të krijoni edukatore të fëmijëve ju po krijoni pastruese, në vend që të krijoni konkurrenca të tregut botëror ju po shtoni barrë për buxhetin e shtetit!

Këto ditë doli edhe raporti Departamentit Amerikan të Shtetit për liritë fetare për vitin 2010. Ku ndër të tjera thuhet se “Zyra e Ombudspersonit, vijon raporti, ka bërë me dije se sërish do të lëshojë një opinion zyrtar, për të theksuar se ndalimi i shamive të kokës nuk është në përputhje me ligjin”.

Ju bëjë thirrje zyrtarëve të ministrisë së arsimit dhe zyrtarëve komunal të arsimit që të lajnë anash paragjykimet dhe bindjet personale dhe të dalin jashtë vetës e të bëjnë veprimet e tyre konkrete-korrekte, të zbatojnë ligjin në përpikëri të kemi njohje dhe kultivimin e diversitetit si vlerë universal, vlerë e popullit të Kosovës.

Ligji të zbatohet edhe aty ku dikujt si pëlqen, sepse në të kundërtën ky vandalizëm politik do ta shpie Kosovën mbrapa, siç është duke e pasqyrua çdo herë në raportet e BE-së se në Kosovë nuk ka zbatueshmëri të ligjit.



Kontributi i prof. Feti Mehdiut në Asamblenë Komunale në Prishtinë



Prof. Fati Mehdiu

Asambleist në KK të Prishtinës

Prof. Feti Mehdiu në Kuvendin Komunal të Prishtinës ka thënë:

- Hamami i Madh në Prishtinë, i ndërtohet në të njëjtën kohë kur ndërtohet edhe Xhamia e madhe, në vitin 1460, është objekt me vlerë të madhe kulturore historike, jo vetëm për Prishtinën por edhe për Kosovën, prandaj

Nuk duhet t i ndërrohet destinimi para se të kryhet restaurimi kështu si është – si banjë publike e shekullit 15. Pastaj të shqyrtohet mundësia për Muze.

- Të kufizohet afati i dhënies së lejeve për ndërtim, ndërmjet lejes urbanistike dhe asaj për ndërtim, **për gjashtë muaj, jo të zgjasë me vite** sepse ashtu zen fill korrupsioni....

- Në lagjen: Medrese-Çamëri, përveç shtigjeve **për biçikleta, çerdheve për fëmijë, shkollës, duhet të caktohet lokacion i përshtatshëm për xhami.** (lokacioni për xhami është caktuar)

- Drejtoria që administron trafikun urban të organizojë për

Nga ekstrakti i procesverbaleve të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës, nga muaji prill 2011, deri në dhjetor 2011

PENSIONISTË DHE PËR STUDENTË të jepen bileta mujore ose vjetore.

- Drejtoria e arsimit të sigurojë pasqyrën e **mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme?** nga shkollat e Prishtinës, nuk mund të jetë reale që shkolla me 100 mijë mungesa, (njëqind mi mungesa) të ketë suksesin 4, 70,

- Duhet ngritë vetëdijen se nga arsimit dalin mjekët, inxhinierët, mësuesit e deri te politikanët e diplomatët ...prandaj arsimit duhet të trajtohet ashtu si e meriton. Shëndetësia vjen menjëherë sepse qeverisjes të çfarëdo niveli qoftë i duhen njerëz të ditur dhe njerëz të shëndoshë. ...

- Statuti i arkivit...nuk është emërtuar drejt: **Arkivi i komunës së Prishtinës** ... duhet të quhet **Arkivi i Qytetit të Prishtinës ose Arkivi i Prishtinës**, ne kemi kërkuar nuk keni dhënë përgjigje a themelohet arkivi i ri, apo është fjala për Statut të Arkivit ekzistues, ... që punon në dy vende... në rr. "Nazim Gafuri" dhe në Arkivin e Kosovës,

- Për korigjimin e emrit personal pala **nuk duhet të paguaj 2€**, nuk ka faj se dikush ia ka gabuar emrin.

- Për ndërrimin e emrit personal që

është një luksoz, në vend të 10€ do të ishte mirë të **paguhet 15€ ose 20 Euro.**

- Për Bastore, jo 500 €, por duhet të jetë 1000 €, me qëllim që të kontribuohet në uljen e krimit, bastoret bëhen burim i krimit.

- tatimi për shitje të librit, ... ose të **hiqet fare** ose të ulet të paktën 70% a 80%, për ta stimuluar ngritjen e shkallës së kulturës së qytetarëve të Prishtinës,

- përkrahim rregulloren për ndalimin e reklamimit të pijeve alkoolike dhe duhanit, Por kërkojmë të shtohet edhe kjo: **"të ndalohet edhe reklamimi i panove ose afisheve që bien ndesh me moralin dhe traditën kombëtare dhe fetare të vendit"**. Kjo ka të bëjë me panot, me të cilat nënçmohet femra si femër, kur trupi i saj i zhveshur ekspozohet në jediese publike të qytetit.

- Përkrahim propozimin që zejet qeleshepunuesit, rrobaqepësit..., **duhet të stimulohen për ta ushtruar zejen e tyre** në një mënyrë, mos tjetër, të lirohen nga tatimi ose të kenë tatim më të vogël për t'i ruajtur si vlera kombëtare, vlera kulturore të këtij vendi dhe të këtij populli.

Këshilli redaktues:

Agim Qehaja (kryetar i degës III)
Jeton Svirca (nënkryetar i partisë, kryetar i degës II)
Shpëtim Potera (sekretar i degës III)
Mynevere Qeshmegjiu (anëtare e kryesisë, nënkryetare për grua dega III)
Feti Mehdiu (anëtarë i kryesisë)
Sami Isufi (nënkryetar dega III)
Agron Terziqi (nënkryetar dega III)
Fatmir Krasniqi (anëtar i kryesisë dega III)
Bernard Tahirbegolli (anëtarë i kryesisë)

Lektor:

Mynevere Qeshmegjiu

Korrektor:

Vlora Ibrahim

Formësimi kompjuterik:

Agim Qehaja
Shpëtim Potera

www.drejtësia.com

newsletter@drejtësia.com



Rr. Bajram Kelmendi Nr.22,

10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

PD DREJTËSIA
PARTIA E DREJTËSISË

SHKURT 2012, NR. 2 BULETIN MUJOR INFORMATIV www.drejtësia.org



Delegacioni nga qyteti i Bursës viziton kryesinë e PD-së
Dega e Gjakovës mban tribunë
Arianit Sllamniku pritet të bëhet asambleist në KK të Gjilanit
Ligjet tona garantojnë manifestimin e lirë të bindjeve fetare
Të drejtat e njeriut dhe vandalizimi politik
Kontributi i prof. Feti Mehdiut në Asambleenë Komunale në Prishtinë